

Rekomandime drejtuar institucioneve të ndryshme nga 01/01/2021 - 31/12/2021

NR.	Nr. Doculive	Data e nisjes	Objekti i Rekomandimit	Institucioni që është dërguar Rekomandimi	Statusi i rekomandimit		Seksioni
1	202002327	27.01.2021	Rekomandim për marrjen e masave për garantimin e të drejtës për arsim dhe programe zhvillimi për fëmijët S.dhe H.H. me aftësi të kufizuara në interesin më të lartë të tyre	1- Bashkisë Krujë 2-DRA Durrës 3-DRSHSSH Durrës	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	SMPDF
2	2001805	29.03.2021	Rekomandim lidhur me ankesën e familjeve në lagjen "Subashi"	Kryetarit të Bashkisë Krujë Për dijeni: 1. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Kulturës 2- z. A. S.	1.1 Pranuar;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	S. Administratës
3	20210663	21.12.2021	Rekomandim për realizimin e infrastrukturës ndërtimore në godinën e Bashkisë Pogradec për personat me aftësi të kufizuara në shikim dhe godinën e Ujësjellës Kanalizime Pogradec sh.a për personat me aftësi të kufizuara në lëvizje dhe në shikim, sipas standardeve të elementëve të përshtatshmërisë, duke përfshirë në këtë proces edhe këta persona.	Drejtuar: 1- Bashkisë Pogradec Për dijeni: 1- Ujësjellës Kanalizime sh.a Pogradec	1.4. Pa përgjigje;		S.Përgjithshëm
4	201502469	18.10.2021	Rekomandim për trajtimin e ankesës së shtetasit O. R.	Drejtuar: 1- Kryeinspektorit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Tiranë	1.4. Pa përgjigje;		S. Administratës
5	201801701	19.05.2021	Rekomandohet ushtrimi i përgjegjësive ligjore nga ana e Bashkisë Kamëz për trajtimin dhe zgjidhjen e problemit të ujërave të zeza në zonën e Laknasit	1- Kryetarit të Bashkisë Kamëz Per dijeni: z. A. H.	1.1 Pranuar;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	S. Administratës

6	201801825	03.02.2021	Rekomandim për marrjen e masave për rikonstruksionin e urës së Proptishtit	1- Kryetarit të Bashkisë Pogradec	1.4. Pa përgjigje;		S. Administratës
7	201802052	12.07.2021	Rekomandim lidhur me ushtrimin e kontroleve dhe marrjen e masave respektive administrative për mbrojtjen e mjedisit në zonën e Spitallës	Drejtuar: 1- Kryetarit të Bashkisë Durrës 2- Kryeinspektorit të Inspektoriatit Shtetëror Shëndetësor, Tiranë 3- Drejtorit të Agjencisë Rajonale të Mjedisit, Durrës 4- Drejtorit të Institutit të Shëndetit Publik, Tirane Për dijeni: Z. Kreshnik Ndreka, Durrës	1.4. Pa përgjigje;		S. Administratës
8	201802468	09.03.2021	Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës – Tirana Veri	1- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës
9	202000208	17.12.2021	Rekomandim për garantimin e të drejtave ligjore të mohuara dhe të identifikuara nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit Social Shtetëror, Tiranë sipas Akt-Kontrollit nr.1103/1 datë 12.10.2018 për alokimin e fondit të nevojshëm për shlyerjen e pagesave të prapambetura të shpenzimeve të energjisë elektrike për vitin 2016 të përfituesve pranë Njesisë Administrative Pezë, në listën e së cilës bën pjesë edhe shtetësja F. K.	Drejtuar: 1- Bashkisë - Tirane Për dijeni: 1- Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror	1.4. Pa përgjigje;		S.Përgjithshëm
10	202000251	30.04.2021	Rekomandim për përshpejtimin e vendimmarrjes për përmbylljen e procesit të legalizimit të banesës së shtetasit R. M., si dhe për shpërblimin e dëmit jashtëkontraktor të shkaktuar ndaj tij.	1- Drejtorisë Vendore Tiranë Rurale 2, në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës Tiranë 2- Bashkisë Tiranë	1.3 Refuzuar		S.Përgjithshëm

11	202000310	16.03.2021	Rekomandohet respektimi i procedurës për miratimin ose refuzimin e kërkesës së të dënuarit për të përfituar leje shpërblyese (rasti i të dënuarit V. M.)	1-Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Veçantë
12	202000383	26.02.2021	Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për të bërë të mundur pranimin në Akademinë e Sigurisë të shtetasit S. S.	1- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Tiranë Për dijeni: Z. S. S.	1.1 Pranuar;	2.3 Pa zbatuar;	S. Veçantë
13	202000430	26.02.2021	Rekomandim për fillimin e hetimeve për ngjarjen e ndodhur me shtetasin E. Sh. në protestën e zhvilluar në qytetin e Tiranës në datën 16.03.2019, identifikimin e drejtuesve të automjeteve ujëdhënëse që kanë dëmtuar ankuesin dhe vënien e tyre para përgjegjësisë ligjore për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare”, parashikuar nga neni 250 i Kodit Penal.	1- Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë	1.3 Refuzuar		S. Veçantë
14	202000509	26.11.2021	Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana-Veri, për moskthim përgjigje	Drejtuar: 1- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Për dijeni: 1- Drejtorisë Vendore të ASHK-së Tirana-Veri	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës
15	202000527	16.06.2021	Rekomandim për marrjen e masave për përfundimin e procesit të kryerjes së veprimeve përmbarimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titullit ekzekutiv, vendimit gjyqësor civil nr.227, datë 26.06.2007, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, në favor të kreditores A. G., trashëgimtarëve të saj ligjorë.	1- Zyrës Përmbarimore Berat 2- Drejtorsë së Përgjithshme të Përmbarimit Tiranë 3- Ministrisë Së Drejtësisë Për Dijeni: Z. V. S.	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës

16	202000535	05.03.2021	Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës – Gjirokastrë	1- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë	1.1 Pranuar;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës
17	202000548	30.03.2021	Rekomandim lidhur me shembjen e 60 objekteve të ndodhura në segmentin Radhimë-Vlorë. Analizimin e këtij rasti, nxjerrjen e përgjegjësive, evidentimin e personave që kanë çuar në cënimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor dhe marrjen e masave ligjore ndaj tyre, si dhe mospërsëritjen në të ardhmen të këtyre procedurave.	1- Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Vlorë 2- Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Tiranë 3- Bashkisë Vlorë	1.3 Refuzuar		S. Administratës
18	202000667	30.07.2021	Rekomandim për evidentimin e personave përgjegjës dhe fillimin e procedurës administrative për marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës – Gjirokastrë	Drejtuar: 1- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës 2- Drejtorisë Vendore të ASHK-së Gjirokastrë Për Dijeni: Z. D. J.	1.4. Pa përgjigje;		S. Administratës

19	202000830	23.12.2021	<p>Rekomandohet kryerja e proçdurave për dhënien e shpërblimit të dëmit, bashkëpronarëve të pasurisë nr.3/277, ZK 8533, në kushtet e shpronësimit faktik të saj nga Bashkia, Fier, pa u kryer proçesi i shpronësimit ligjor.</p> <p>Rekomandohet përfundimi i menjëhershëm i proçedurave të shpronësimit për pasurinë nr.3/277, ZK 8533, si dhe përcjellja e praktikës për vendimmarrje në Këshillin e Ministrave.</p> <p>Rekomandohet identifikimi i personave përgjegjës për shkeljen e të drejtave të ligjshme të ankueses dhe bashkëpronarëve të tjerë, në nivel vendor dhe qendror, si dhe për moszbatimin e praktikave korrekte administrative ligjore në këtë çështje.</p>	<p>Drejtuar: 1- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë 2- Bashkisë Fier</p>	1.4. Pa përgjigje;		S. Administratës
20	202000838	12.07.2021	<p>1. Rekomandohet ngritja e grupeve të punës për verifikimin dhe kontrollin e zbatimit të dispozitave të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007, i ndryshuar, në procesin e ushtrimit të përgjegjësisë mbi ndërtimin e ndodhur në Rrugën “Abdyl Frashëri”, pallati 7/1(11), njësia e banimit nr.6, kati 2, Njësia Administrative nr.5, Tiranë.</p> <p>2. Rekomandohet nxjerrja e përgjegjësive administrative ose penale si dhe vendosja e gjobës ndaj kryeinspektorëve dhe inspektorëve të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, pranë Bashkisë Tiranë, për veprime ose mosveprime në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, të ndryshuar.</p>	<p>Drejtuar: 1- Kryeinspektorit të Inspektoriatit Kombëtar të Mjedisit dhe Territorit Tirane Për dëgjim: 1- Z. J. L.</p>	1.4. Pa përgjigje;		S. Administratës

21	202000887	30.07.2021	Rekomandim për evidentimin e personave përgjegjës dhe fillimin e procedurës administrative për marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës – Pogradec	Drejtuar: 1- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës 2- Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Pogradec Për Dijeni: 1- Z. S. H., Pogradec	1.1 Pranuar;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës
22	202001544	01.03.2021	Rekomandohet përfundimi i procedurave të shqyrtimit të vetëdeklarimit të shtetasit D. S. për legalizim e një pasurie të paluajtshme.	1- Drejtorit të Drejtorisë Vendore Tirana Rurale 2- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë 3- Për dijeni: Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK-së 4- Administratorit të Njësië Administrative Kashar Tirane	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës
23	202001553	24.12.2021	Rekomandim për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të spitalit Ihsan Çabej, për moskthim përgjigje	Drejtuar: 1- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 2- Spitalit Rajonal "Ihsan Çabej", Lushnje	1.1 Pranuar;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	S. Administratës
24	202001624	20.12.2021	Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Bashkisë Krujë, por moskthim përgjigje.	Drejtuar: 1- Bashkia Krujë Për dijeni: 1- R. B., Tiranë	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës
25	202001645	03.06.2021	Rekomandohet nxjerrja e aktit administrativ për refuzimin e regjistrimit të sipërfaqes prej 659m ² njohur në pronësi dhe kthyer në natyrë ankuesit sipas vendimit nr.309, datë 25.10.1995, të dhënë prej Komisionit të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave, pranë Këshillit të Rrethit Kurbin, duke i'u bërë me dije dhe Avokatit të Shtetit	1- Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kurbin 2- Për dijeni: B. H.	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës

26	202001667	16.06.2021	Rekomandohet fillimi menjëhershëm i procedurës administrative për regjistrim të AMTP nr. 41, datë 25.05.1993 në emër të trashëgimtarëve të familjes bujqësore A. H., në përputhje me VKM Nr. 1174, datë 24.12.2020 "Për Procedurat e Regjistrimit të AMTP-ve, Saktësimin e Kufijve e Sipërfaqeve, si dhe Normat Për Sipërfaqet Shtetërore Shtesë e Pronat Shërbyese".	1- Drejtoria Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Sarandë 2- Agjencia Shtetërore e Kadastrës Tiranë Për dijeni: Z. E. H.	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës
27	202001696	15.06.2021	Rekomandim për përmirësimin e procedurës që ka të bëjë me njohjen e të burgosurit me masën disiplinore të dhënë ndaj tij dhe kohën (afatin) kur duhet të zbatohet ajo (rasti i të dënuarit K. M.)	1- Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve 2- Drejtorit të IEVP Malësi e Madhe	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Veçantë
28	202001716	25.03.2021	Rekomandohet ushtrimi i përgjegjësive ligjore nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor Vau Dejës në lidhje me ekzekutimin e vendimit për prishje nr. 2 datë 18.01.2016, si edhe përfundimi i procedurave të evidentimit dhe ofrimit të ndihmës shtetërore për ankuesin.	1- Kryetarit të Bashkisë Vau Dejës Për dijeni: 1- Kryeinspektorit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Tiranë 2- Kryeinspektorit të Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Dega Shkodër	1.1 Pranuar;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	S. Administratës
29	202001770	16.07.2021	Rekomandim lidhur me mospërbushjen e detyrimit ligjor për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimit Nr 170 datë 09.04.2015, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Gjirokastër, në kuadër të respektimit të të drejtës për një proces të rregullt ligjor	Drejtuar: 1- Znj. Anila Denaj, Ministre e Financave dhe Ekonomisë 2- Znj. Milva Ikonomi, Ministre e Bujqësisë dhe e Zhvillimit Rural	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës

30	202001792	21.12.2021	<p>Rekomandohet nxjerrja e vendimit nga ana e Bashkisë Tiranë, për përjashtimin nga pagimi i taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore si dhe të tarifës së pastrimit, për shtetasin Z. Ç..</p> <p>Rekomandohet rikthimi i vlerave në të holla, të paguara nga shtetasi Z. Ç., në Bashkinë Tiranë si taksë e përkohshme për infrastrukturën arsimore dhe tarifë pastrimi, që nga data 1.10.2019.</p> <p>Marrjen e masave që të mos ndodhin në të ardhmen keqinterpretime të tilla flagrante të ligjit.</p>	<p>Drejtuar: 1- Bashkia Tiranë Për dijeni: 1- Z. Ç., Shkodër</p>	1.4. Pa përgjigje;		S. Administratës
31	202001848	24.12.2021	<p>Rekomandim për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të bashkisë Delvinë, për moskthim përgjigje.</p>	<p>Drejtuar: 1- Kryetares së Bashkisë Delvinë</p>	1.4. Pa përgjigje;		S. Administratës
32	202001882	22.04.2021	<p>Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës – Gjirokastër.</p>	<p>Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë Për dijeni: Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër</p>	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës
33	202001882	30.07.2021	<p>Rekomandim për marrjen e masave për përfundimin e procesit administrativ të regjistrimit të pasurisë së poseduar nga shtetasi S. G.</p>	<p>Drejtuar: 1- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Për dijeni: 1- Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër</p>	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës

34	202001944	12.03.2021	Rekomandim për zgjidhjen e kërkesave të parashtruara nga ana e një gupi mjekësh të shërbimit të mjekësisë interne dhe hipertensionit arterial dhe nxjerrjen e akteve nënligjore përkatëse	1- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1.4. Pa përgjigje;		S.Përgjithshëm
35	202001974	07.04.2021	Rekomandim për marrjen e masave dhe fillim të procedurave për: - regjistrimin në regjistrat e pasurive të paluajtshme të pasurisë truall dhe ndërtesë të përfituar sipas VKM-së nr. 432, datë 14.08.1995 dhe aplikuar me nr. 2713, datë 17.07.2018; - fillimin e procedurës disiplinore ndaj specialistëve të DVASHK Gjirokastër për mostrajtim të aplikimeve/kërkesave konform legjislacionit aktual në fuqi.	1- Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Gjirokastër 2- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë Për Dijeni: Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Dropull	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës
36	202001977	05.03.2021	Rekomandim për marrjen e masave për përfundimin e procesit administrativ të legalizimit të objektit informal, i vetë deklaruar nga shtetasi A. K. dhe regjistrimin e tij.	1- Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës-Tirana Veri 2- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë Për Dijeni: Z. A. K.	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës
37	202001982	04.06.2021	Rekomandim për marrjen e masave për shpërblimin e z. H. D., për banesën e dëmtuar për shkaqe natyrore, nxjerrjen e përgjegjësisë dhe evidentimin e personave që kanë çuar në cënimin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor, si dhe mospërsëritjen në të ardhmen të këtyre procedurave.	1- Bashkisë Tropojë 2- Per dijeni: H. D.	1.1 Pranuar;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës
38	202001985	09.06.2021	Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës – Shkodër	Agjencië Shtetërore të Kadastrës Për dijeni: Drejtorisë Vendore të ASHK Shkodër	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës

39	202001991	24.08.2021	Rekomandim për trajtimin e çështjes së shtetasve L. Z., D. A., R. S., S.S., M. H..	Drejtuar: 1- Policisë Bashkiake Tiranë Për dijeni: Znj. L. Z., etj	1.3 Refuzuar		S. Administratës
40	202001999	15.11.2021	Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës - Sarandë, pr moskthim përgjigje	Drejtuar: 1- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Për dijeni: 1- Drejtorisë vendore të ASHK-së Sarandë	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës
41	202002017	22.11.2021	Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për kthimin e sendeve personale të sekuestruara nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan shtetasve të huaj M. M., H. A., M. M., M. N., A. R., A. X. dhe A. J..	Drejtuar: 1- Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Elbasan 2- Prokurorisë së Përgjithshme 3- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit Për dijeni: 1- Drejtorit Ekzekutiv të Qendrës "Tirana Art"	1.4. Pa përgjigje;		MKPT
42	202002072	16.03.2021	Rekomandohet fillimi i procedurës administrative dhe marrja e masave disiplinore ndaj punonjësve të Bashkisë Tepelenë.	1- Kryetarit të Bashkisë Tepelenë Për dijeni: Z. H. Ç.	1.3 Refuzuar		S. Administratës
43	202002098	09.03.2021	Rekomandim për marrjen e masave për përfundimin e procesit administrativ të legalizimit të objektit informal, i vetë deklaruar nga shtetasi B. S. dhe regjistrimin e tij	1-Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës-Tirana Jug 2- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë Për dijeni: Av. B. R.	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës

44	202002157	07.01.2021	Rekomandim për marrjen e masave për rishikimin e dosjes së dëmshpërblimit nr. 19555 të ish të dënuarit politik H. K., duke rivlerësuar trashëgimtarët dhe mënyrën e dhënies së kësteve për znj. B. S. në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi.	1- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë Z. Oltjon Muzaka	1.3 Refuzuar		S. Veçantë
45	202002188	20.12.2021	Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës – Tirana Veri, për moskthim përgjigje.	Drejtuar: 1- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Për dijeni: 1- Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Veri	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës
46	202002196	22.11.2021	Rekomandim për marrjen e masave për përfundimin e procesit administrativ të legalizimit të objektit informal, i vetë deklaruar nga shtetasi Z. M. dhe regjistrimin e tij	Drejtuar: 1- Drejtorisë Vendore të ASHK-së Kuçovë 2- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Për dijeni: 1- Z. M.	1.4. Pa përgjigje;		S. Administratës
47	202002207	11.01.2021	Rekomandim për garantimin e lirisë së organizimit dhe tubimeve paqësore të fëmijëve	1- Ministrisë së Brendshme 2- Ministrisë së Drejtësisë 3- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit 4- Agjencisë Shtetërore për të Drejtat dhe Mbrojtjen e Fëmijës	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	SMPDF

48	202002276	20.12.2021	<p>Rekomandohet marrja e masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimit të vendosur sipas Vendimit Gjyqësor Administrativ Nr. 3014 datë 18.11.2020 të dhënë me Ekzekutim të Përkohshëm prej Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.</p> <p>Rekomandohet fillimi i procedurës administrative për të adresuar mungesën e komunikimit me Institucionin e Avokatit të Popullit për marrjen e masës disiplinore ndaj personit përgjegjës parashikuar në nenin 58 të Ligjit Nr. 152/ 2013 "Për Shërbimin Civil", i ndryshuar, në përputhje me procedurat e parashikuara ligjore.</p>	<p>Drejtuar:</p> <p>1. Drejtorisë së Përgjithshme të Rrugëve dhe Ndriçimit Publik;</p> <p>2. Bashkia Tiranë</p>	1.4. Pa përgjigje;		S. Administratës
49	202002289	25.03.2021	<p>Rekomandohet përcjellja e informacionit dhe fillimi i procedurave të regjistrimit fillestar të pasurisë së ankuesit.</p>	<p>1- Kryetarit të Bashkisë Himarë Per dijeni:</p> <p>1- Drejtorit të Drejtorisë Vendore ASHK-së Vlorë</p> <p>2- Z. M. D.</p>	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës
50	202002293	07.05.2021	<p>Rekomandim për analizimin e rastit të punonjësve të Policisë Bashkiake Tiranë të cilët kanë kryer veprime me shtetasin S. S..</p>	<p>1- Drejtorit të Policisë Bashkiake Tiranë</p> <p>2- Për dijeni: Z. S. S.</p>	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Veçantë
51	202002435	30.07.2021	<p>Rekomandim për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës – Pogradec</p>	<p>Drejtuar:</p> <p>1- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Për Dijeni:</p> <p>Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, Pogradec</p>	1.1 Pranuar;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës

52	202002446	18.10.2021	Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për përmirësimin të procedurave të pranimit dhe akomodimin e familjareve të azilkërkuesve në Shqipëri	Drejtuar: 1- Znj. Elena Pici Sekretar i Përgjithshëm ne Ministrine e Brendshme Për dijeni: 1- Z. Ermir Aliçka Drejtore i Qendrës Kombëtare të Pritjes për Azilkërkuesit Babrru	1.1 Pranuar;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	MKPT
53	202002645	08.07.2021	Rekomandim për marrjen e masave organizativo-administrative për shmangien e ngjarjeve të humbjes së jetës apo dëmtimit të shëndetit të personave të shoqëruara në ambientet e strukturave të policisë, si edhe përmirësimin e procedurës standarde për rregullat e shoqërimit të personave të dehur si rezultat i konsumimit të tepërt të pijeve alkoolike.	Drejtuar: 1- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit 2- Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Veçantë
54	202002664	24.12.2021	Rekomandim për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të bashkisë Fier, për moskthim përgjigje.	Drejtuar: 1- Kryetares së Bashkisë Fier	1.4. Pa përgjigje;		S. Administratës
55	202002709	15.06.2021	Rekomandim për përfundimin e procedurës administrative për fitimin e titullit akademik "Profesor", nga kandidati z. A. B.	Universitetit të Tiranës Kryetares se Komisionit të Promovimit të Personelit Akademik Kozeta Sevrani	1.4. Pa përgjigje;		S.Përgjithshëm
56	202002777	17.03.2021	Rekomandim për dhënien e masës disiplinore oficerit të policisë gjyqësore I. B., efektiv i Komisaritit të Policisë Durrës, për kontroll të paligjshëm të banesës së shtetasit G. K. dhe analizimin e qëndrimit indiferent dhe pasiv të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Durrës lidhur me këtë rast.	1- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë të Shtetit Tiranë 2- Prokurorisë së Përgjithshme 3- Këshillit të Lartë të Prokurorisë Tiranë Për Dijeni: Presidencës së Republikës	1.1 Pranuar;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	S. Veçantë

57	202002859	07.12.2021	Rekomandohet plotësimi në mënyrë të qartë e të kuptueshme të dokumenteve mjekësore të lëshuara nga mjekët dhe marrja e masave për kalimin për aq sa është e mundur nga përshkrimi me shkrim dore i tyre, në formë elektronike	Drejtuar: 1- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 2- Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve 3- Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Korçë	1.1 Pranuar;	2.3 Pa zbatuar;	S. Veçantë
58	202002862	25.01.2021	Rekomandohet ushtrimi i përgjegjësive dhe kompetencave ligjore nga IVMT Sarandë lidhur me ndërtimin e denoncuar nga shtetasi K. B.	1. Kryetarit të Bashkisë Sarandë 2- Kryeinspektorit të IMT Sarandë Për dijeni: 3- Kryeinspektorit të IKMT Sarandë	1.1 Pranuar;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	S. Administratës
59	202002892	16.03.2021	Rekomandohet fillimi i procedurës administrative për pajisjen me Leje Legalizimi dhe regjistrimin në regjistrat e pasurive të paluajtshme në emër të z. B. K.	1- Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tirana Rurale 1 Tiranë 2- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Tiranë	1.3 Refuzuar		S. Administratës
60	202002959	15.11.2021	Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës - Pogradec	Drejtuar: 1- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës - Tiranë Për dijeni: 1- Drejtorisë vendore të ASHK-së Pogradec	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës
61	202002968	30.07.2021	Rekomandim për marrjen e masave për ardhjen në ndihmë dhe përfshirjen e shtetases P. N. në një nga programet e strehimit social apo ndihmës ekonomike	Drejtuar: 1- Bashkisë Fier Për dijeni: Znj. P. N.	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës
62	202003088	03.03.2021	Rekomandohet fillimi i procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Bashkia Këlcyrë	1- Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Tiranë 2- Kryeinspektorit të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit Bashkia Këlcyrë	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës

63	202003088	13.12.2021	<p>Rekomandohet marrje masash të menjëhershme për prishje të objektit informal të subjektit F. T. në zbatim të vendimit nr. 1919, datë 31.12.2018 të ish-ALUIZNI Gjirokastër për përjashtim nga procesi legalizimi.</p> <p>Rekomandohet nxjerrja e përgjegjësiwe administrative ose penale si dhe vendosja e gjobës ndaj kryeinspektorit dhe inspektorëve të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, pranë Bashkisë Këlcyrë, për veprime ose mosveprime në kundërshtim me parashikimet e dispozitave ligjore në fuqi dhe në përputhje me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007, të ndryshuar</p>	<p>Drejtuar:</p> <p>1- Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit në Bashkinë Këlcyrë 2- Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit Tiranë</p> <p>Për dijeni:</p> <p>1- S. G. - Tiranë</p>	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës
64	202003093	07.12.2021	<p>Kërkesë për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të Drejtorisë Vendore të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës - Shkodër, për moskthim përgjigje</p>	<p>Drejtuar:</p> <p>1- Agjencisë Shtetërore të Kadastrës</p> <p>Për dijeni:</p> <p>1- Drejtorisë Vendore të ASHK-së Shkodër 2- L. E.- Shkodër</p>	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës
65	202003094	24.12.2021	<p>Rekomandim për fillimin e procedurës administrative dhe marrjen e masave disiplinore ndaj punonjësve përgjegjës të bashkisë Fier, për moskthim përgjigje.</p>	<p>Drejtuar:</p> <p>1- Administratorit të Termocentralit Sh.a Vlorë</p>	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	S. Administratës
66	202003104	08.10.2021	<p>Rekomandim për marrjen e masave në bashkëpunim me Dhomën e Avokatisë së Shqipërisë për zbatimin e vendimeve gjyqësore për ndihmën juridike të garantuar nga shteti (rasti i shtetasit F. H.)</p>	<p>Drejtuar:</p> <p>1- Ministrisë së Drejtësisë Drejtorisë së Ndihmës Juridike Falas</p> <p>Per dijeni</p> <p>1- Dhomës së Avokatisë të Shqipërisë, Tirane 2- Dhomës Vendore të Avokatisë Shkodër</p>	1.1 Pranuar;	2.3 Pa zbatuar;	S. Veçantë

67	202003133	27.05.2021	<ul style="list-style-type: none"> • Marrjen e masave të menjëherëshme për kompensimin financiar të pagesave të nxënësve të shkollës së mesme të mjeshtresë Sportive Loro Boriçi, Tiranë për periudhën shtator-dhjetor 2020. • Marrjen e masave të menjëherëshme për arritjen e marrëveshjes me FSHF-në dhe nëse nuk arrihet kjo marrëveshje mbulimin e shpenzimeve financiare për nxënësit që zhvillojnë stërvitje në fushat e kësaj të fundit. 	<p>1- Sekretarit të Përgjithshëm Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë</p> <p>2- Për dijeni: Drejtorit të Shkollës së Mesme të Mjeshtresë Sportive “Loro Boriçi” Tiranë</p>	1.4. Pa përgjigje;		S.Përgjithshëm
68	202003140	20.01.2021	Rekomandim për përshpejtimin e procesit të vendimmarrjes ndaj vetëdeklarimit për legalizim të kryera nga individë, me përkatësi në minoritetin kombëtar Rom dhe atë Egjiptian	1- Drejtoria Vendore e ASHK Tirana Jug	1.1 Pranuar;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	S.Përgjithshëm
69	202003141	29.07.2021	Sugjerojmë përfshirjen e diagnozës “Hemiplegji” në përfitimin e Statusit të Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik	Ministritë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale Sekretarit të Përgjithshëm	1.3 Refuzuar		S.Përgjithshëm
70	202003147	02.07.2021	Rekomandohet përmbushja e detyrimeve ligjore nga ana e strukturave të Bashkisë dhe Drejtorisë Vendore të ASHK Vlorë.	<p>Drejtuar:</p> <p>1- Kryetarit të Bashkisë Vlorë</p> <p>2- Drejtorit të Drejtorisë Vendore të ASHK Vlorë</p> <p>Për dijeni: Drejtorit të Përgjithshëm të ASHK Tiranë</p>	1.4. Pa përgjigje;		S. Administratës
71	202003153	18.01.2021	Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Durrës.	<p>1- Drejtori i Përgjithshëm i Burgjeve</p> <p>2- Drejtori IEVP Durrës</p>	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	MKPT

72	202003159	30.04.2021	Rekomandim për marrjen e masave të nevojshme për ndryshimin e pikave 2, 5, 7 dhe 8 të Rregullores “Për kushtet dhe rregullat e zënies së hapësirës publike në Bashkinë e Tiranës”, miratuar me Vendimin e Këshillit Bashkiak Tiranë nr. 130, datë 15.11.2018.	1- Këshillit Bashkiak Tiranë	1.1 Pranuar;	2.3 Pa zbatuar;	S. Veçantë
73	202003160	13.12.2021	Rekomandohet fillimi dhe përfundimi i procedurës administrative për legalizim të objektit pa leje në emër të shtetasit Nevruz Kovaçi sipas vetëdeklarimit nr. 660 prot., datë 24.03.2005 dhe pajisje me dokument pronësie sipas përcaktimeve ligjore në ligjin nr. 20/2020 “Për Përfundimin e Proceseve Kalimtare të Pronësisë në RSH”. Agjencia Shtetërore e Kadastrës të vlerësojë në përputhje me Ligjin nr. 111/2018 “Për Kadastrën”, veprimtarinë e Drejtorisë Vendore të Kadastrës Pogradec mbi respektimin e legjislacionit aktual të pronësisë si dhe respektimin e afateve procedurale në shqyrtim të akteve për ofrimin e shërbimeve nga kjo drejtori konform legjislacionit aktual	Drejtuar: 1- Drejtoria Vendore e ASHK-së Pogradec 2- Agjencia Shtetërore e Kadastrës Për dijeni: 1- Z. N. K. – Pogradec 2- Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit - Pogradec	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Administratës
74	202003162	26.05.2021	Rekomandohet përmirësimi i kushteve të trajtimit të të paraburgosurve dhe të dënuarve në Institutin e të Miturve Kavajë.	1- Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve 2- Drejtorit të Institutit të të Miturve Kavajë	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	MKPT

75	202003187	30.07.2021	Rekomandim për marrjen e masave të menjëhershme për përfundimin e procesit të ndërhyrjes dhe prishjes së objektit të kundërligjshëm të ndërtuar nga z.R. B.. Nxjerrjen e përgjegjësive administrative (dhe/ose penale në rast se ka vend për këtë masë) ndaj personave përgjegjës.	Drejtuar: 1- Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Berat 2- Inspektoriatit Kombëtar të Mbrojtjes së Territorit, Tirane 3- Ministri së Drejtësisë Për Dijeni: Znj. D. B.	1.1 Pranuar;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	S. Administratës
76	202003231	12.03.2021	Rekomandim për marrjen e masave të menjëherëshme, për: (i) zgjerimin e paktetës së barnave për trajtimin ambulator në banesë të personave të diagnostikuar me COVID-19, duke përfshirë në të analizat laboratorike dhe ekzaminimet imazherike për diagnostikim dhe monitorim të ecurisë klinike të pacientit; (ii) Garantimin e ofrimit pa asnjë diskriminim të shërbimit shëndetësor duke përfshirë si kategori përfituese edhe individët të diagnostikuar me Covid -19, për periudhën Mars-Nëntor 2020. (iii) Garantimin e ofrimit pa asnjë diskriminim të shërbimit shëndetësor edhe të pacientëve që janë konfirmuar pozitiv me tampon nga institucionet shëndetësore private.	1- Zj.Ogerta Manastirliu Ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale	1.3 Refuzuar		S.Përgjithshëm
77	202003243	06.05.2021	Rekomandim për marrjen e masave, për garantimin e interesit më të lartë të fëmijëve të shtetas A. H.	1- Bashkisë Shkodër, Drejtorisë së Shërbimit Social 2- Njësisë Administrative Ana e Malit 3- Zyrës Vendore Arsimore Për dijeni: Ministrisë së Arsimit, Sportit Dhe Rinisë	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.3 Pa zbatuar;	SMPDF

78	202003250	07.05.2021	Rekomandohet mbyllja e I.E.V.P. Krujë, si dhe sistemimi i menjëhershëm i personave me probleme të shëndetit mendor që trajtohen në kundërshtim me ligjin në këtë institucion, në pavijone psikiatrike që administrohen nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, deri në ngritjen e institucioneve të posaçme mjekësore sipas përcaktimit të ligjit të ri nr. 44/2012 "Për Shëndetin Mendor.	1- Ministrit të Drejtësisë 2- Ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 3- Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve 4- Drejtorit të IEVP Krujë Për Dijeni: Kryeministrit të Republikës së Shqipërisë	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	MKPT
79	202003251	25.05.2021	Rekomandohet përmirësimi i kushteve dhe trajtimi i personave që trajtohen në I.V.SH.B. Tiranë.	1- Ministërit të Drejtësisë 2- Ministërit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale 3- Drejtori të Përgjithshëm të Burgjeve 4- Drejtorit të Institucionit të Veçantë Shëndetësor të Burgosurve	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	MKPT
80	202003260	07.05.2021	Rekomandim për shfuqizimin e Urdhërit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr. 4218 prot., datë 13.05.2019 "Për administrimin e telefonatave që kryhen nga të dënuarit dhe paraburgosurit në IEVP".	1-Ministrit të Drejtësisë	1.3 Refuzuar		S. Veçantë
81	202003260	06.12.2021	Përsëritje rekomandimi për shfuqizimin e Urdhrit të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve nr. 4218 prot., datë 13.05.2019 "Për administrimin e telefonatave që kryhen nga të dënuarit dhe paraburgosurit në IEVP".	Drejtuar: 1- Ministrit të Drejtësisë	1.4. Pa përgjigje;		S. Veçantë
82	202003266	04.05.2021	Rekomandim për përmirësime të nevojshme në qasjen dhe aksesin ndaj shërbimeve të kujdesit shëndetësor, për komunitetet Rome dhe Egjiptiane.	1- Operatorit të Kujdesit të Shërbimit Shëndetësor Tiranë 2- Institutit të Shëndetit Publik Tiranë	1.1 Pranuar;	2.3 Pa zbatuar;	S.Përgjithshëm
83	202003268	09.06.2021	Rekomandojmë dhënien e pagesës kalimtare për periudhën 23.09.2020-22.10.2020 shtetasit A. T.	Drejtorit te IEVP Tepelene	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S.Përgjithshëm

84	202003270	30.07.2021	Rekomandohet marrja e nismës për ndryshim në legjislacion dhe ndryshimi i praktikës administrative	Drejtuar: 1- Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale 2- Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë 3- Bashkisë Tiranë Për dijeni: Z. A. G.	1.2 Pranuar Pjesërisht;	2.3 Pa zbatuar;	S. Administratës
85	202003277	26.11.2021	Rekomandim për marrjen e masave të menjëherëshme, për dhënien e fondit të përcaktuar si “Shpërblim për regjistrim të lindjes brenda afatit ligjor” për banorët e Njësisë Administrative Buçimas, Bashkia Pogradec	Drejtuar: 1- Ministrit të Brendshëm 2- Kryetarit të Bashkisë Pogradec Për dijeni: 1- Administratorit të Njësisë Administrative Buçimas	1.1 Pranuar;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	S.Përgjithshëm
86	202003288	06.05.2021	Rekomandohet përmirësimi i menjëherëshëm i kushteve dhe i trajtimit të të dënuarve dhe paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale të IEVP-së Kosovë, Lushnjë.	1- Drejtorit të Përgjithshëm të burgjeve 2- Drejtorit të IEVP-së Kosovë - Lushnje	1.1 Pranuar;	2.2 Zbatuar Pjesërisht;	MKPT
87	202003298	03.02.2021	Rekomandojmë marrjen e masave për ndihmën e menjëherëshme lidhur me strehimin dhe fuqizimin ekonomik të familjes të z.A. P..	1- Bashkisë Dibër 2- Për dijeni: Shtetasit A. P. Dibër	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S.Përgjithshëm

88	202003310	30.07.2021	Rekomandim për zbatimin me korrektësi të rasteve dhe kritereve ligjore të shoqërimit të shtetasve, në ambientet e organeve të Policisë së Shtetit si dhe për garantimin e të drejtës së ushtrimit të profesionit dhe raportimit të ngjarjeve nga punonjësit e medias të pranishëm në tubime apo aktivitete të tjera të kësaj natyre	Drejtuar: 1- Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit 2- Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë 3- Drejtorisë Vendore të Policisë Durrës	1.1 Pranuar;	2.1 Zbatuar Plotësisht;	S. Veçantë
